

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria gati për të pajisur me shtëpi të rinjtë, Rama: Dy mijë kredi me interes zero për apartamentet që kushtojnë poshtë 60 mijë euro! Kush përfiton tjetër nga programi
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/qeveria-gati-per-te-pajisur-me-shtepi-te-rinjte-rama-dy-mij-e-kredi-me-i-i400881
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 12:15:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 12:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	65ac4e81c74a36e448c24a68c0032dd6a67fc7f0824a0e7ba4c813533470a4aa
TEKSTI	b9fb503de512b636b04830f3f7f13da5105212f81bcbaad3145e73b344b98fb5
PAMJA	2ea659f1c1dbbbe274c7bfd4140696a0ce2e0c21ad06b30877ed746cbe29009d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7e0ebe84fbffc5cbf024a93851fce00674bd52c92f4fa6b3da1d12ed98dca464
E MËPARSHMJA	15d64f0ea26d4b9debe35c34482853dbfc33ad782a167822a46fd76b2be2db40
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e0ebe84fbffc5cbf024a93851fce00674bd52c92f4fa6b3da1d12ed98dca464>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Politikë](#) 10 Shtator 2026, 14:04

Qeveria gati për të pajisur me shtëpi të rinjtë, Rama: Dy mijë kredi me interes zero për apartamentet që kushtojnë poshtë 60 mijë euro! Kush përfiton tjetër nga programi

Shkruar nga Newsbomb



 Qeveria gati për të pajisur me shtëpi të rinjtë, Rama:
Edi Rama

Kreu i qeverisë Edi Rama ka marrë pjesë ditën e sotme në eventin për prezantimin e Programit Kombëtar të Strehimit për Shqipërinë “Rilindja 2.0”. Gjatë fjalës së tij, kreu i qeverisë bëri të ditur 6 pikat e këtij programi, të cilat do t’u vijnë në ndihmë qytetarëve sa i përket strehimit të tyre.

Sipas Ramës, 4 mijë çifte të reja do të pajisen me çelësat e banesave, ndërsa do të jepen 2 mijë kredi me interes zero për apartamente me vlerë deri në 60 mijë euro. Dy mijë kredi të tjera do të ofrohen me interes 3% për apartamente me vlerë mbi 60 mijë euro.

“Do pajisim 4 mijë çifte të reja me çelës për shtëpi. Sipas kriterëve që do bëhen të qarta, po këtu nuk hyjnë kreditë e lidhura me administratën. 4 mijë çifte të ndarë sipas kategorive, janë 2 mijë kredi me interes zero. Për cdo apartament nën 60 mijë euro, dhe këtu flasim për apartamente të vogla, do të zerojmë kredinë. Ndërsa 2 mijë kredi të tjera do të jenë me interes 3 % për apartamente mbi 60 mijë euro. Strehimi social është vetëm një komponent, sot përballemi me një problem botëror. Një studim i fundit në Suedi, sot një i ri suedez mund të blejë më pak se 2 metra katror me kredi, jo nga xhepi. Pra, jemi në kushtet kur nuk kemi të bëjmë vetëm me të pamundurit, por me njerëz që kanë të ardhura, por s mund të blejnë një shtëpi me ato të ardhura që kanë. Kemi të bëjmë me burime njerëzore që s mund t’ia lejojmë vetes t’i konsiderojmë të dorës së dytë”, tha Rama.

Programi i ri parashikon gjithashtu zgjerimin e skemës së banesave sociale me qira, përmes ndërtimit të banesave të reja, blerjes së tyre në treg, përshtatjes së objekteve shtetërore apo të konfiskuara, si dhe përdorimit të partneriteteve publike-private.

Një tjetër komponent është mbështetja për banesat me kosto më të ulët, përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet vulnerabël dhe ndërhyrjet infrastrukturore në zonat informale.

Në kuadër të programit do të krijohen edhe zona të reja strehimi, të konceptuara për të gjitha shtresat e shoqërisë, ndërsa një tjetër pikë lidhet me ndërtimin e banesave të përkohshme për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore.

Pjesë e “Rilindja 2.0” janë edhe banesat e përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, me synim krijimin e kushteve më të përshtatshme dhe të aksesueshme për jetesë.

-

[Edi Rama pranon mungesën e Veliajt, jep lajmin e mirë për banorët e Tiranës: Kryeqyteti pa kokë solli shumë viktima! Do përfundojë rindërtimi i banesave](#)

10 Shtator, 14:33

Rama e cilësoi programin si pjesë të një reforme më të gjerë strukturore në fushën e strehimit, ndërsa bëri të ditur se drafti ligjor për këtë reformë pritet të kalojë së shpejti në konsultim publik dhe

me pas ne kuvendu.

“Kështu që Rilindja 2.0 është një vizion i ngritur në një nivel tjetër në një sërë aspektesh dhe strehimin e ka aspektin e vet thelbësor. Janë gjashtë programe të reja të cilat ne do t'i adresojmë të gjitha së bashku dhe kur them të reja nuk kam parasysh shpikje, pasi janë terma të njohur, por janë të ambalazuara së bashku në një reformë tërësore, siç e thashë”, tha Rama ndër të tjera.

Pjesë nga fjala e kryeministrit:

Së pari nuk është një program i ri kombëtar thjesht dhe vetëm financiar. Por është një program i ri kombëtar si mishërim i një reforme strukturore shumë të thellë e cila tanimë ka marrë formën e drafrit ligjor, së shpejti do të kalojë në konsultim publik dhe pastaj në parlament për të ndryshuar qasjen ndaj kësaj teme kaq të rëndësishme dhe gjithmonë më të mprehtë për shkak të vështirësive që hasin familjet e reja dhe të rinjtë në tërësi në rrugën e marrjes së një shtëpie. Të jem shumë i qartë që kjo nuk është një temë e nxehtë dhe thjesht e vetëm në Shqipëri.

Ky nuk është një problem thjesht dhe vetëm lokal, ky është një problem i madh europian dhe jo vetëm është një problem i madh europian dhe sa më të zhvilluara të jenë vendet e Europës, aq më i madh është problemi. Ky është një nga ato rezultatet të zhvillimit të këtyre viteve me të cilat duhet të përballemi në një formë tjetër. Sepse tanimë zhvillimi i dekadës së fundit ka ndryshuar tërësisht optikën e njerëzve lidhur me vendin dhe me vendin e tyre në këtë vend. Kështu që Rilindja 2.0 është një vizion i ngritur në një nivel tjetër në një sërë aspektesh dhe strehimin e ka aspektin e vet thelbësor. Janë gjashtë programe të reja të cilat ne do t'i adresojmë të gjitha së bashku dhe kur them të reja nuk kam parasysh shpikje, pasi janë terma të njohur, por janë të ambalazuara së bashku në një reformë tërësore, siç e thashë.

Programi i parë është programi i banesave sociale me qira, është një skemë e mirënjohur e përdorur ndër vite, por të cilën ne dhe faktikisht dhënia e banesave me qira do të jetë një program i cili do të bëhet më kompleks dhe do thjesht dhe vetëm prirje të ndërtohet edhe pastaj të kesh shansin të marrësh një banesë në një radhë të gjatë ku nuk i dihet si përfundon seleksioni. Banesat sociale me qira do të parashikojnë ndërtim të ri, blerje të drejtpërdrejta nga tregu, përshtatje të objekteve shtetërore ose të objekteve të konfiskuara dhe këtu dua të përsëris që kemi konfiskuar jo pak objekte dhe do të konfiskojmë çdo objekt që shkel rregullat për lejet e ndërtimit dhe patjetër bonusi në qira, por po ashtu partneritetin publik-privat. Do të përdorim të gjitha instrumentet për të garantuar një ofertë shumë më të gjerë nga ana e shtetit për ata që duhet dhe do të mund të marrin banesë sociale me qira.

Pastaj është banesa me kosto më të ulët, i cili lidhet me subvencionin nga ana e shtetit të kredisë, duke pasur parasysh që banesa e kredituar të hyjë në kategori e banesave me kosto të ulët dhe për këtë ka një kategorizim të mirëpërcaktuar.

Pastaj vijmë të përmirësimi i banesave ekzistuese për grupet vulnerabel, si dhe një projekt, një program i veçantë infrastrukture në zonat informale dhe për të adaptuar banesa të caktuara si banesa sociale. Programi ka një zhvillim të ri me zhvillimin e zonave të strehimit dhe këtu nuk flasim vetëm për banesat sociale në kuptimin vetëm për ata në nevojë, por flasim për të gjitha shtresat e shoqërisë, s'duam të krijojmë një bllok banimi vetëm për njerëzit e varfër, por për të gjitha shtresat, ndërkohë që ata më të varfërit do të kenë mbështetje për të jetuar aty, ata më të kamurit do të blejnë aty.

Zonat e strehimit do të synojmë të jenë zona cilësore në çdo aspekt. Dhe për këtë do të shërbejë dhe reforma strukturore. Shumë shpejt ne do të fillojmë në Tiranë me këtë program të ri dhe kemi në shqyrtim një sërë zonash të tjera në Bashki të tjera, ku natyrisht janë të ftuar të gjithë kryetarët e bashkive të bëjnë propozimet e tyre.

Programi tjetër është ai i banesave të përkohshme, do të duhet të ndërtojmë banesa të përkohshme në kuptimin e të pasurit në dispozicion një infrastrukturë e gatshme nga njerëzit e prekur nga fatkeqësitë natyrore.

Dhe programi i gjashtë është i atyre që mund t'i quajmë banesa të veçanta, të cilat janë banesa të përshtatura për familjen me persona me aftësi të kufizuara apo për individët me aftësi të kufizuara.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Politikë

[Gjyqtarët ia çuan ministrin e Financave në SPAK, Edi Rama i sfidon: Mungon emri im aty, ai është konsultuar me mua për pagat](#)

E Enjte 12:49

Politikë

[Takimi me zyrtaren e lartë amerikane, Gazment Bardhi zbardh bisedën me Nancy VanHorn \(FOTO\)](#)

E Enjte 12:29

Politikë

[Sali Berisha prej ditësh në Amerikë, e ngarkuara me punë e ambasadës së SHBA-së takim “kokë më kokë” me Gazment Bardhin \(VIDEO\)](#)

E Enjte 11:35

Politikë

[Belind Këlliçi poston video me Donald Trump, ndjekësit të “shqetësuar” për Berishën: Po Saliun ku e ke?](#)

E Enjte 11:21

Politikë

[Ilir Meta i kyçur nga bota dhe i “harruar” në qeli, Komiteti i Helsinkit letër burgut “313”: Pse nuk po e lejoni të takojë deputetët e tij dhe ata europianë? \(FAKSIMILE\)](#)

E Enjte 09:52

Politikë

[Takimi i socialistëve te Vila e Kuqe, Rama nxjerr VIDEON: Njerëzit të jenë të qetë për të qarë hallet, jo të bëhen filmime për Instagram](#)

E Enjte 08:25 Newsbomb

Politikë

[Rama nxjerr VIDEON humoristike, na prezanton me Altinin nga Peza, pesë breza socialist: Tatuazhet tregojnë se ky është ambientalist](#)

E Mërkurë 20:15 Newsbomb

Politikë

[80-vjetori i Kryengritjes së Postribës, Sali Berisha mesazh nga Amerika: Dëshmi e gjallë se një komb nuk mund të mbahet përgjithmonë i nënshtuar](#)

E Mërkurë 16:51

Politikë

[Lajmet se aktivistja Arvina Lleshi “u rrëmbye” me urdhër të saj, reagon Iris Luarasi: Qelbësirlleku nuk quhet gazetari, po më poshtëroni publikisht](#)

E Mërkurë 15:00

Politikë

["Më erdhi një dosje tjetër, është tmerr", Arben Ahmetaj zotohet "për luftë" dhe zbulon nga i merr informacionet kritike për situatën në Shqipëri](#)

E Mërkurë 14:34

Politikë

[SPAK nisi hetimet për përgjimet e tij, Arben Ahmetaj shfaqet nga arratia: Shpresoj që të bien në duart e prokurorëve të ndershëm, sepse është trafik armësh](#)

E Mërkurë 14:10

Politikë

[Shehaj dhe Kapri çojnë në Parlamentin gjerman protestën e flamingove: Beteja e Tiranës, duhet të mbështetet në çdo kryeqytet të Europës \(FOTO\)](#)

E Mërkurë 13:44

Politikë

[Audiopërgjimi i publikuar dhe akuzat e Ahmetajt ndaj tij, reagon për herë të parë ministri Ermal Nufi: Çfarë trafiku armësh? A jeni në terezi? \(VIDEO\)](#)

E Mërkurë 13:40

Politikë

[Nisin punimet për impiantin e ujërave të ndotura në Durrës, Karakaçi: 85 milionë euro grant nga Bashkimi Europian, parashikohen 113 km rrjete të reja](#)

E Mërkurë 13:14

Politikë

[Peleshi takohet me ambasadoren e re të BE-së: Kuvendi i Shqipërisë do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet europiane](#)

E Mërkurë 12:26

Politikë

[Marjana Koçeku pakt me demokratët? Çfarë mesazhi donte t'i jepte Ramës kur shkoi të ulej pranë "armiqve" të tij politikë](#)

E Mërkurë 12:15

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Aktualitet

[SPAK sqaron mos realizimin e takimit të avokatëve të huaj me Veliajn: Nuk ka refuzim, por pamundësi organizative](#)

E Enjte 14:43

Aktualitet

[Edi Rama pranon mungesën e Veliajt, jep lajmin e mirë për banorët e Tiranës: Kryeqyteti pa kokë solli shumë viktima! Do përfundojë rindërtimi i banesave](#)

E Enjte 14:31

[Zbulohet më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek "Mbretëresha Geraldinë", vjen në jetë në lindje me natyrë djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)

op
ed

OpEd

Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

Një moment vendimtar për Shqipërinë

E Martë 13:45

OpEd

Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtor i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

ME REGJISTRO

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.